<p>siguruar gjurmët e auditimit për të gjitha proceset në kuadër të subjektit dhe listat për kontroll financiare për të gjithë personelin e financave të subjektit publik;</p> <p>3. Zyrtari kryesor financiar ngarkohet me zbatimin e përgjegjësi sipas nenit 8 të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Llogaridhënia e menaxherëve /mbajtësve të buxhetit të subjektit të sektorit publik</b></p> <p>1. Menaxherët e strukturave të brendshme të subjektit të sektorit publik, në cilësinë e udhëheqësit të programeve, nënprogrameve apo aktiviteteve, janë përgjegjës dhe llogaridhënës ndaj mbikëqyrësve të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, sipas nivelit hierarkik për:</p> <p>1.1. menaxhimin e aktiviteteve dhe rreziqeve që lidhen me realizimin e objektivave të strukturave që mbulojnë;</p> <p>1.2. raportimin në kohën e duhur për rezultatet e arritura dhe masat e marra për minimizimin e rreziqeve;</p> <p>1.3. menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve dhe buxhetit për të cilat u janë deleguar përgjegjësitë;</p>	<p>processes within the entity and financial controls checklist for all finance personnel of the public entity.</p> <p>3. The Chief Financial Officer shall be in charge of implementing the responsibilities under article 8 of this Law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Accountability of Managers/ Budget Holders of public sector entity</b></p> <p>1. Managers of the internal structures of the public sector entity, as the heads of programmes, sub programs or activities shall be responsible and accountable to their direct superior according to the hierarchic level for:</p> <p>1.1. managing the activities and the risks related to the achievement of the structural objectives they are in charge of;</p> <p>1.2. timely reporting about the results achieved and actions taken to mitigate the risks;</p> <p>1.3. managing and controlling the activities and budget for which responsibilities have been delegated to;</p>	<p>za sve procese unutar popisa subjekata za financijske kontrole za sve osoblje finansija javnog subjekta;</p> <p>3. Glavni financijski službenik zadužen je za sprovođenje obaveza iz člana 8. ovoga Zakona.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Upravljačka odgovornost Rukovodilaca / nositelja budžeta subjekta javnog sektora</b></p> <p>1. Rukovodioci unutarašnjih struktura subjekta javnog sektora, koa Rukovodilac programa, potprograma ili aktivnosti, su odgovorni i imaju neposrednu rukovodilačku odgovornost prema svojim nadzornicima, prema hijerarhijskom nivou:</p> <p>1.1. i upravljanje aktivnosti i rizicima u vezi ostvarivanja ciljeva strukture koje pokrivaju;</p> <p>1.2. pravovremeno izveštavanje o postignutim rezultatima i poduzetim merama za minimiziranje rizika;</p> <p>1.3. upravljanje i kontrolu aktivnosti i budžeta za koje su delegirane odgovornosti;</p>
--	---	--



<p>1.4. raportimin tek eprori përkatës për çfarëdo mangësie që duhet adresuar; dhe</p> <p>1.5. bashkëpunimin me Zyrtarin kryesor financiar për planifikimin dhe ekzekutim e buxhetit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Komponentët e menaxhimit financiar dhe të kontrollit</b></p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik zbaton menaxhimin financiar dhe kontrollin përmes një kornize të komponentëve të brendshëm të kontrolleve të ndërlidhur me:</p> <p>1.1. mjedisin e kontrollit të brendshëm;</p> <p>1.2. vendosjen e objektivave;</p> <p>1.3. menaxhimin e rrezikut;</p> <p>1.4. aktivitetet e kontrollit;</p> <p>1.5. informacionin dhe komunikimin; dhe</p> <p>1.6. monitorimin.</p>	<p>1.4. report to the respective supervisor of any deficiency that need to be addressed; and</p> <p>1.5. collaboration with the chief financial officer for budget planning and execution.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Components of the Financial Management and Control</b></p> <p>1. The Head of the Public Sector Entity shall perform Financial Management and Control through a framework of interrelated internal control components, with:</p> <p>1.1. internal Control Environment;</p> <p>1.2. objective Setting;</p> <p>1.3. risk Management;</p> <p>1.4. control Activities;</p> <p>1.5. information and communication; and</p> <p>1.6. monitoring.</p>	<p>1.4. izveštavanje odgovarajućem starešini za bilo kakve nedostatke koje treba rešavati; i</p> <p>1.5. saradnju sa Glavnim finansijskim službenikom za planiranje i izvršenje budžeta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Komponente finansijskog upravljanja i kontrole</b></p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora sprovodi finansijsko upravljanje i kontrolu kroz okvir komponente unutrašnje kontrole vezane sa:</p> <p>1.1. sredinom unutrašnje kontrole;</p> <p>1.2. uspostavom ciljeva;</p> <p>1.3. upravljanjem rizika;</p> <p>1.4. aktivnostima kontrole;</p> <p>1.5. informacijom i komonukacijom, i</p> <p>1.6. nadzorom.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Mjedisi i kontrollit të brendshëm</b></p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik është përgjegjës për mjedisin e kontrollit të brendshëm, i cili përfshin:</p> <p>1.1. përkushtimin ndaj integritetit dhe vlerave etike;</p> <p>1.2. strukturat adekuate organizative, linjat e raportimit, autoritetin e nevojshëm dhe përgjegjësitë në arritjen e objektivave; dhe</p> <p>1.3. politikat e menaxhimit të rrezikut, duke përcaktuar se sa rrezik mund të bart subjekti dhe qasjen për zvogëlimin e rrezikut.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Internal Control Environment</b></p> <p>1. The Head of the public sector entity shall be responsible for the internal control environment, which includes:</p> <p>1.1. Commitment to integrity and ethical values;</p> <p>1.2 Adequate organizational structures, reporting lines, and necessary authorities and responsibilities in the achievement of objectives; and</p> <p>1.3 Risk management policy, defining how much risk the organisation can take and risk mitigation approach.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Sredina unutrašnje kontrole</b></p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora je odgovoran za sredinu unutrašnje kontrole, koja obuhvata:</p> <p>1.1. predanost prema integriteta i etičkim vrednostima;</p> <p>1.2. odgovarajuće organizacijske strukture, linije izveštavanja, odgovornosti i odgovornosti potrebne za postizanje ciljeva; i</p> <p>1.3. politike upravljanja rizicima određivanjem koliko rizika može snositi subjekat i pristup za minimiziranje rizika.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Vendosja e objektivave</b></p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik siguron që objektivat e subjektit të jenë të vendosura në planet strategjike dhe vjetore, dhe të dokumentuara sipas kategorive, si në vijim:</p> <p>1.1. strategjike - bazuar në planet strategjike të subjektit;</p> <p>1.2. operative - bazuar në planet e veprimit të subjektit;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Objective setting</b></p> <p>1. The Head of the Public Sector Entity shall ensure that entity's objectives are set in strategic and annual plans and are documented in the following categories:</p> <p>1.1 strategic - based on the strategic plans of the entity;</p> <p>1.2 operational - based on the action plans of the entity;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Postavljanje ciljeva</b></p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora osigurava da ciljevi subjekta koji se nalaze u strateškim i godišnjim planovima, te dokumentovanim prema kategorijama, kako sledi:</p> <p>1.1. strateški - na osnovu strateških planova subjekta;</p> <p>1.2. operativni - na osnovu plana akcije subjekta;</p>

<p>1.3. financiare - bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, në Ligjin Vjetor të Buxhetit si dhe rregulloret e aplikueshme financiare; dhe</p> <p>1.4. pajtueshmërisë - bazuar në kornizën e aplikueshme ligjore.</p>	<p>1.3 financial - based on the Mid-term Expenditure Framework, Annual Budget Law and applicable financial regulations; and</p> <p>1.4 compliance - based on the applicable legal framework.</p>	<p>1.3. finansijski- na osnovu Srednjoročnog okvira troškova, u Godišnjem Zakonu Budžetu kao i primjenjivim finansijskim propisima; i</p> <p>1.4. usklađenost – na osnovu važećeg zakonskog okvira.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Menaxhimi i rrezikut</b></p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të dokumentuar në kuadër të subjektit, i cili përfshin:</p> <p>1.1. identifikimin e ngjarjeve që mund të ndikojnë arritjen e objektivave;</p> <p>1.2. vlerësimin e rrezikut lidhur me mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin; dhe</p> <p>1.3. veprimet ndaj rrezikut me qëllim të shmangies, transferimit, pranimit, ndarjes apo zvogëlimit të rrezikut.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Risk Management</b></p> <p>1. The Head of the Public Sector Entity shall be responsible for the risk management documented within the entity, which includes:</p> <p>1.1 identification of events that might affect the achievement of the objectives;</p> <p>1.2 risk assessment in terms of likelihood and impact; and</p> <p>1.3 risk response in terms of avoiding, transferring, accepting, sharing or mitigating the risk.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Upravljanje rizikom</b></p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora je odgovoran za upravljanje rizicima dokumentovanog u okviru subjekta, što obuhvata:</p> <p>1.1. identifikaciju događaja koji mogu uticati na ostvarivanje ciljeva;</p> <p>1.2. procena rizika u vezi s mogućnošću događanja i uticaja; i</p> <p>1.3. radnje koje se poduzimaju za izbjegavanje rizika, prenosa, primitka, podele ili minimiziranje rizika.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Aktivitetet e kontrollit</b></p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe procedurave të cilat sigurojnë që rreziqet menaxhohen ashtu siç parashihen</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Control Activities</b></p> <p>1. The Head of the Public Sector Entity shall be responsible for the enforcement of policies and procedures ensuring that risks are managed as intended by the risk</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Aktivnosti kontrole</b></p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora je odgovoran za sprovođenje politika i postupaka koji osiguravaju da se rizicima upravlja tako kako je predviđeno planom</p>

<p>në planin për menaxhimin e rrezikut, dhe së paku përfshin:</p> <p>1.1. procedurat për autorizim dhe aprovim;</p> <p>1.2. ndarjen e detyrave për aprovim, realizim, kontabilitet dhe kontroll;</p> <p>1.3. sistemin për nënshkrim të dyfishtë;</p> <p>1.4. rregullat për qasje në pasuri dhe informata;</p> <p>1.5. rishikimin e pajtueshmërisë para ndodhjes;</p> <p>1.6. procedurat për plotësi, besueshmëri, saktësi dhe në kohën e duhur për operacionet e kontabilitetit;</p> <p>1.7. kontrollet pas faktit të ndodhjes;</p> <p>1.8. rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore; dhe</p> <p>1.9. rregullat për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe aktiviteteve të subjektit.</p>	<p>management plan and include at least:</p> <p>1.1 procedures for the authorisation and approval;</p> <p>1.2 segregation of duties for approval, execution, accounting and control;</p> <p>1.3 double signature system;</p> <p>1.4 rules on access to assets and information;</p> <p>1.5 ex-ante compliance review;</p> <p>1.6 procedures for completeness, reliability, accuracy and timeliness of accounting operations;</p> <p>1.7 ex-post controls;</p> <p>1.8 rules for management of human resources; and</p> <p>1.9 rules for documenting all transactions and activities of the entity.</p>	<p>upravljanja rizicima, a najmanje obuhvata:</p> <p>1.1. postupke za ovlašćenje i usvajanje;</p> <p>1.2. izdvajanje dužnosti na usvajanje, izvršenje, računovodstvo i kontrolu;</p> <p>1.3. sistem za dvostruki potpis;</p> <p>1.4. pravila za pristup na imovinu i informacije;</p> <p>1.5. pregled usklađenosti prije nastanka;</p> <p>1.6. postupci za popunjenost, pouzdanost, tačnost i pravodobno za računovodstvene poslove;</p> <p>1.7. kontrole nakon činjenice nastanka ;</p> <p>1.8. pravila za upravljanje ljudskim resursima; i</p> <p>1.9. pravila za dokumentiranje svih transakcija i aktivnosti subjekta.</p>
---	--	---

<p align="center"><b>Neni 14</b> <b>Informimi dhe komunikimi</b></p>	<p align="center"><b>Article 14</b> <b>Information and Communication</b></p>	<p align="center"><b>Član 14</b> <b>Informisanje i saopštenje</b></p>
<p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik është përgjegjës për besueshmërinë, rëndësinë dhe integritetin e informatave, nëpërmjet vendosjes së sistemit të informimit dhe komunikimit, për të siguruar që:</p> <p>1.1. informatat e mjaftueshme dhe të rëndësishme komunikohen në kohë nga dhe për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik dhe personelin e subjektit të sektorit publik, në mënyrë që ata të mund të përmbushin detyrat dhe obligimet e tyre;</p> <p>1.2. informatat e mjaftueshme, rëndësishme dhe të përshtatshme i afrohen çdo pale të tretë siç janë klientët, furnitorët, organet mbikëqyrëse, tatimpaguesit dhe palëve të ngjashme;</p> <p>1.3. të gjitha veprimet, transaksionet, proceset, vendimet janë të dokumentuara në mënyrë që të krijohet një gjurmë e auditimit; dhe</p> <p>1.4. sistemi i raportimit të ketë afate kohore dhe pajtueshmërinë, përfshirë raportimin e gabimeve, parregullsive dhe dyshimet për mashtrim.</p>	<p>1. The Head of the Public Sector Entity shall be responsible for the reliability, relevance, relevance, and integrity of information, by establishing an information and communication system, ensuring that:</p> <p>1.1 sufficient and relevant information is communicated in a timely manner from and to the Head of the Public Sector Entity and staff members of Public Sector Entity so that they can fulfil their duties and obligations;</p> <p>1.2 sufficient, relevant and appropriate information is provided to any external party such as customers, suppliers, supervisory bodies, tax payers and related parties;</p> <p>1.3 all operations, transactions, processes, decisions are documented in order to create an audit trail; and</p> <p>1.4 the reporting system provides for timelines and compliance, including reporting on errors, irregularities and suspicions of fraud.</p>	<p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora je odgovoran za pouzdanost, relevantnost i integritet podataka, kroz uvođenje sistema informisanja i saopštavanja, kako bi se osigurale:</p> <p>1.1.dovoljne i važne informacije saopštavaju na vreme od i za Rukovodioca javnog sektora i osoblje subjekta javnog sektora, kako bi oni mogli ispuniti svoje dužnosti i obveze;</p> <p>1.2. se dovoljne, relevantne i odgovarajuće informacije pruže trećim stranama, kao što su kupci, dobavljači, nadzorna tela, poreskii obveznici i sličnim strankama;</p> <p>1.3. dhe sve akcije, transakcije, procesi, odluke dokumentiraju, kako bi se stvorio revizijski trag; i</p> <p>1.4. sistem za izveštavanje ima raspored i usklađenost, uključujući i izveštavanje pogrešaka, nepravilnosti i sumnje o prevari.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 15 Monitorimi</b></p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik siguron sistemin për monitorimin e cilësisë së funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe garanton përditësimin dhe korrigjimin e tij me kohë, sipas rrethanave.</p> <p>2. Auditimi i brendshëm përkrah udhëheqësin e subjektit të sektorit publik në monitorimin e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</p> <p>3. Monitorimi kryhet në vazhdimësi, nëpërmjet vetëvlerësimeve vjetore për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe vlerësimeve të veçanta, dhe i raportohet Ministrisë së Financave.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15 Monitoring</b></p> <p>1. Head of the Public Sector Entity shall establish a system for monitoring the quality of Financial Management and Control functioning, and shall guarantee its timely update and adjustment to the circumstances in place.</p> <p>2. Internal audit shall support the Head of the Public Sector Entity in monitoring the functioning of Financial Management and Control.</p> <p>3. Monitoring shall be on-going, through annual Financial Management and Control self-assessment, and separate evaluation and shall be reported to the Ministry of Finance.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15 Monitorisanje</b></p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora osigurava sistem za monitorisanja kvaliteta funkcionisanja finansijskog upravljanja i kontrole, te osigurava pravovremeno ažuriranje i ispravljanje, prema okolnostima.</p> <p>2. Unutrašnja revizija podržava Rukovodioca subjekta javnog sektora u monitoringu funkcionisanja finansijskog upravljanja i kontrole.</p> <p>3. Monitorisanje se sprovodi kontinuirano kroz godišnje samoprocene za finansijsko upravljanje i kontrolu i za posebne procene izveštava Ministarstvo finansija.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 16 Raportimi për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm</b></p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik siguron që çdo vit të kryhet vetëvlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit, në të gjithë subjektin e sektorit publik, dhe miraton raportin vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm.</p> <p>2. Raporti vjetor përfshinë deklaratën e kontrollit të brendshëm, raportin e vetëvlerësimit të menaxhimit financiar dhe</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16 Reporting on Internal Control System</b></p> <p>1. The Head of the Public Sector Entity shall ensure that Financial Management and Control self-assessment is carried out every year within the entire Public Sector Entity and shall approve the annual report on internal control system.</p> <p>2. The annual report shall include Internal Control Statement, the self-assessment Financial Management and Control report,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16 Izveštavanje o sistemu unutrašnje kontrole</b></p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora osigurava da se svake godine vrši samoprocene finansijskog upravljanja i kontrole, u čitavom subjektu javnog sektora, te usvaja godišnji izveštaj o sistemu unutrašnje kontrole.</p> <p>2. Godišnji izveštaj sadrži izjavu unutrašnje kontrole, izvještaj samoprocene sistema finansijskog upravljanja i kontrole</p>

<p>të kontrollit dhe rezultatet e aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>3. Subjektet e qeverisjes qendrore, lokale dhe fondet e veçanta i dorëzojnë raportin vjetor Ministrisë së Financave, me përbërje sipas paragrafit 2 të këtij neni, deri në fund të muajit maj, sipas procedurave të përcaktuara nga Ministria e Financave.</p>	<p>and results of internal and external audit activities.</p> <p>3. Central government entities, local government entities and special funds shall submit their annual report to the Ministry of Finance, according to composition of paragraph 2 of this Article, by the end of the month of May, based on procedures established by the Ministry of Finance.</p>	<p>i rezultate aktivnosti unutrašnje i spoljne revizije.</p> <p>3. Subjekti centralne vlade, lokalne samouprave i posebna fondove podnose Godišnji izveštaj Ministarstvu finansija, u sastavu prema stavu 2. ovoga člana, do kraja maja meseca, u skladu s postupcima utvrđenim od Ministarstva finansija.</p>
<p><b>KAPITULLI III</b> <b>AUDITIMI I BRENDSHËM</b></p>	<p><b>CHAPTER III</b> <b>INTERNAL AUDIT</b></p>	<p><b>POGLAVLJE III</b> <b>UNUTARAŠNJA REVIZIJA</b></p>
<p><b>Neni 17</b> <b>Funksioni i auditimit të brendshëm</b></p>	<p><b>Article 17</b> <b>The internal audit function</b></p>	<p><b>Član 17</b> <b>Funkcija unutrašnje revizije</b></p>
<p>1. Auditimi i brendshëm ofron siguri të pavarur dhe objektive për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe ofron këshilla për përmirësimin e tij.</p> <p>2. Shërbimi i sigurisë është ekzaminim objektiv i dëshmisë me qëllim të ofrimit të vlerësimit të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit të subjektit të sektorit publik.</p> <p>3. Fushëveprimi i shërbimit këshillëdhënës bëhet në pajtim me udhëheqësin e subjektit</p>	<p>1. The internal audit shall provide independent and objective assurance to the Head of a Public Sector Entity on the adequacy and effectiveness of the Financial Management and Control System and advice for its improvement.</p> <p>2. The assurance service shall be an objective examination of evidence for the purpose of providing an independent assessment of governance, risk management, and control processes of the Public Sector Entity.</p> <p>3. The scope of the consulting service shall be agreed with Head of the Public</p>	<p>1. Unutrašnja revizija pruža nezavisnu i objektivnu sigurnost za Rukovodioca subjekta javnog sektora o usaglašenosti i efikasnofinancijskog upravljanja i kontrole, te pruža savete za njegovo poboljšanje.</p> <p>2. Služba sigurnosti je objektivno ispitivanje svih dokaza radi pružanja nezavisne procene vladanja, upravljanja rizikom i procesa kontrole subjekta javnog sektora.</p> <p>3. Delokrug savetodavne službe se radi u skladu sa Rukovodiocem subjekta javnog</p>

<p>të sektorit publik, që përfshinë shërbimet e këshillimit, konsultimit dhe shërbimet e trajnimit, me qëllim që të ndihmojë subjektin e sektorit publik për të arritur objektivat e tij.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Parimet e funksionit të auditimit të brendshëm</b></p> <p>1. Auditimi i brendshëm në sektorin publik ushtrohet bazuar në standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës, metodologjinë e miratuar nga Ministri i Financave dhe në pajtueshmëri me parimet, si në vijim:</p> <p>1.1. ligjshmërinë;</p> <p>1.2. paanshmërinë dhe integritetin;</p> <p>1.3. pavarësinë dhe objektivitetin;</p> <p>1.4. profesionalizimin dhe kujdesin e duhur profesional; dhe</p> <p>1.5. kompetencën dhe konfidencialiteti.</p>	<p>Sector Entity that includes counselling, consultation and training services intended to help the Public Sector Entity to achieve its objectives.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 18</b> <b>Principles of Internal Audit function</b></p> <p>1. Internal Audit in the Public Sector shall be exercised based on the internal audit standards, Code of Ethics, methodology issued by the Minister of Finance and in compliance with the following principles:</p> <p>1.1. legality;</p> <p>1.2. impartiality and Integrity;</p> <p>1.3. independence and objectivity;</p> <p>1.4. professionalism and due professional care; and</p> <p>1.5. competence and confidentiality.</p>	<p>sektora, što obuhvata savetodavne usluge, konsultacije i usluge obuke kako bi se pomoglo subjektu javnog sektora u postizanju svojih ciljeva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Načela funkcije unutrašnje revizije</b></p> <p>1. Unutrašnja revizija u javnom sektoru ostvaruje se osnovu standarda unutrašnje revizije, etičkog kodeksa, metodologiji odobrenoju od Ministra finansija, te u skladu s načelima, kako sledi:</p> <p>1.1. zakonitost</p> <p>1.2. nepristranost i integritet;</p> <p>1.3. nezavisnosti i objektivnost;</p> <p>1.4. profesionalnost i dobra profesionalnost i pažnjom; i</p> <p>1.5. nadležnost i povjerljivost.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Themelimi i funksionit të auditimit të brendshëm</b></p> <p>1. Njësia e auditimit të brendshëm themelohet në subjektet e sektorit publik, në përputhje me kriteret e miratuar nga</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Establishment of internal audit function</b></p> <p>1. The internal audit unit shall be established in the Public Sector Entities in accordance with the criteria adopted by the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Osnivanje funkcije unutrašnje revizije</b></p> <p>1. Jedinica unutrašnje revizije se osniva u subjektima javnog sektora, u skladu s kriterijumima koje je usvojila Vlada</p>



<p>Qeveria e Kosovës me akt nënligjor, pas propozimit të Ministrit të Financave.</p> <p>2. Njësia e auditimit të brendshëm vendoset sipas njërës nga mënyrat si në vijim:</p> <p>2.1. njësi e pavarur e auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejtë të udhëheqësit të subjektit të sektorit publik;</p> <p>2.2. njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Financave;</p> <p>2.3. nëpërmjet një marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër, me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo</p> <p>2.4. nëpërmjet kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.</p> <p>3. Njësia e auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik mbulon të gjithë subjektin e sektorit publik, përveç organeve të vartësisë që kanë njësi të auditimit të brendshëm.</p>	<p>Government of Kosovo, by sublegal act upon the proposal of the Minister of Finance.</p> <p>2. The internal audit unit shall be established in one of the following forms:</p> <p>2.1. independent Internal Audit Unit that is directly subordinated to Head of the Public Sector Entity;</p> <p>2.2. Joint Internal Audit Unit based on the criteria set forth by the Ministry of Finance;</p> <p>2.3. Upon agreement for providing internal audit service from one Public Sector Entity to another, with prior approval of the Minister of Finance; or</p> <p>2.4. Upon contracting a professional company for performing internal audit, following the approval by the Ministry of Finance.</p> <p>3. Internal audit unit in Public Sector Entity shall cover the entire Public Sector Entity, except the subordinated bodies with their own internal audit unit.</p>	<p>Kosova podzakonskim aktom, nakon predloga Ministra finansija.</p> <p>2. Jedinica unutrašnje revizije je uspostavlja se prema jednim od sledećih načina:</p> <p>2.1. nezavisna jedinica za unutrašnju reviziju neposrednu podređenu od rukovodioca subjekta javnog sektora;</p> <p>2.2. zajednička jedinica unutrašnje revizije prema kriterijumima koje je postavilo Ministarstvo finansija;</p> <p>2.3. kroz sporazum za pružanje usluga unutrašnje revizije iz subjekta javnog sektora u drugi, uz prethodnu suglasnost Ministra finansija; ili</p> <p>2.4. ugovaranjem profesionalne firme za obavljanje unutrašnje revizije, nakon odobrenja od Ministarstva finansija</p> <p>3. Jedinica unutrašnje revizije u subjektu javnog sektora pokriva čitav subjekat javnog sektora, osim podređenih organa koje imaju jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Komiteti i Auditimit</b></p> <p>1. Komiteti i Auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.</p> <p>2. Komiteti i Auditimit themelohet dhe funksionon në subjektet e sektorit publik në bazë të kriterëve të vendosura nga Ministri i Financave.</p> <p>3. Komiteti i Auditimit në subjektet e sektorit publik sipas nenit 2, paragrafi 1.2, themelohet dhe funksionon sipas legjisllacionit në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Audit Committee</b></p> <p>1. Audit Committee shall be an independent advisory body for the head of public sector entity and shall support the internal auditors.</p> <p>2. Audit Committee shall be established and function in the public sector entity upon criteria defined by the Minister of Finance.</p> <p>3. Audit Committee in public sector entities according to 2.1.2 shall be established and function in conformity with the applicable legislation.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Odbor za reviziju</b></p> <p>1. Odbor za reviziju je nezavisni savetodavni organ za Rukovodioca subjekta javnog sektora, i podrška za unutrašnje revizore.</p> <p>2. Odbor za reviziju osnovan je i deluje u subjektima javnog sektora na osnovu kriterijumima utvrđenim od strane Ministra finansija.</p> <p>3. Komitet za reviziju kod subjekta javnog sektora prema članu 2 stav 1.2 osniva se i funkcioniše prema zakonodavstvu na snazi.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Pavarësia funksionale e njësisë së auditimit të brendshëm</b></p> <p>1. Njësia e auditimit të brendshëm është funksionalisht e pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik.</p> <p>2. Në raport me strukturat tjera organizative në subjektin e sektorit publik, njësia për auditimin e brendshëm ka pavarësinë funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Functional Independence of internal audit unit</b></p> <p>1. The internal audit unit shall be functionally independent and directly and solely reporting to the Head of the Public Sector Entity.</p> <p>2. The functional independence of internal audit unit in relation to other organisational units in the Public Sector Entity shall be in audit work planning, performing auditing and in reporting.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Funkcionalna nezavisnost jedinice za unutaršju reviziju</b></p> <p>1. Jedinica za unutaršjuunutaršju reviziju je funkcionalno nezavisna i neposredno izveštava samo Rukovodiocu subjekta javnog sektora.</p> <p>2. U odnosu na ostale organizacione strukture subjekta javnog sektora, jedinica za unutaršjuunutaršju reviziju ima operativnu samostalnost u planiranju revizije, obavljanju revizije i izveštavanju.</p>

<p align="center"><b>Neni 22</b> <b>Përbërja e njësisë së auditimit të brendshëm dhe rekrutimi i auditorëve të brendshëm</b></p>	<p align="center"><b>Article 22</b> <b>Composition of Internal Audit Unit and recruitment of internal auditors</b></p>	<p align="center"><b>Član 22</b> <b>Sastav Jedinice za unutrašnju reviziju i zapošljavanje unutrašnjimunutrašnjih revizora</b></p>
<p>1. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga auditorët e brendshëm të cilët punësohen sipas dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për shërbyesit civil, të dispozitave të Ligjit të Punës apo dispozitave të ligjeve të veçanta.</p> <p>2. Auditorët e njësisë së auditimit të brendshëm duhet të kenë kualifikimet si në vijim:</p> <p>2.1. diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet;</p> <p>2.2. certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave.</p> <p>3. Çdo auditor i brendshëm i pa certifikuar që është në marrëdhënie pune me subjektin e sektorit publik në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, obligohet që të certifikohet sipas paragrafit 2.2 të këtij neni më së</p>	<p>1. Internal Audit Unit is composed of internal auditors recruited under the provisions of the applicable legislation on civil servants or the provisions of the Labour Law or the provisions of special laws.</p> <p>2. Internal audit unit auditors shall have the following qualifications:</p> <p>2.1 have university degree in economics, law, public administration, public finances or other fields of study relevant to the sector to be audited;</p> <p>2.2 hold an internal audit certification in the Public Sector issued by Ministry of Finance or a certification for public sector internal auditors from other international or local relevant institution in compliance with criteria issued by the Minister of Finance.</p> <p>3. Every internal auditor not certified, employed with the public sector entity, on the date when this Law enters into force is obliged to be certified according to paragraph 2.2, of this article no later than</p>	<p>1. Jedinica za unutrašnjuunutrašnju reviziju se sastoji od unutrašnjimunutrašnjih revizora koji su zaposleni na osnovu odredbi primenjivog zakona za državne službenike ili na odredbama Zakona o radu.</p> <p>2. Revizori jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju moraju imati sledeće kvalifikacije:</p> <p>2.1. diplomu univeziteta u ekonomiji, prava, javnoj upravi, javnim finansijama i drugim područjima relevantnim za sektor gde se vrši revizija;</p> <p>2.2. sertifikat unutrašnje revizije u javnom sektoru, koji izdaje Ministarstvo finansija ili sertifikat unutrašnjeg revizora u javnom sektoru od bilo koje međunarodne ili lokalne institucije u skladu s kriterijumima koje donosi Ministar finansija.</p> <p>3. Svaki ne-sertifikovani unutaršnji revizor, koji je u radnom odnosu sa subjektom javnog sektora na dan stupanja na snagu ovog Zakona, dužan je se sertifikuje u skladu sa stavkom 2.2. ovog</p>

<p>largu dy (2) vite prej hyrjes në fuqi të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b> <b>Përgjegjësia e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për funksionin e auditimit të brendshëm</b></p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:</p> <p>1.1. siguron burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe tjera për të mundësuar funksionimin e auditimit të brendshëm në mënyrë efektive;</p> <p>1.2. miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm dhe i dorëzon në Njësinë Qendërore Harmonizuese, më së largu deri më 31 dhjetor të vitit fiskal;</p> <p>1.3. siguron zbatimin e rekomandimeve të pajtuara për auditimin e brendshëm;</p> <p>1.4. dorëzon Njësisë Qendërore Harmonizuese raportin vjetor për aktivitetet e auditimit të brendshëm, sipas nenit 16 të këtij Ligji.</p>	<p>two years upon the entry of this Law into force.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 23</b> <b>Responsibility of the Head of Public Sector Entity for Internal Audit Function</b></p> <p>1. The Head of the Public Sector Entity shall:</p> <p>1.1 ensure sufficient human, financial and other resources to enable the functioning of the internal audit effectively;</p> <p>1.2 endorse the strategic and annual plans of internal audit and submit them to the Central Harmonisation Unit, no later than 31 December of the fiscal year;</p> <p>1.3. ensure the implementation of agreed internal audit recommendations;</p> <p>1.4. submit an annual report on internal audit activities to the Central Harmonisation Unit according to Article 16 of this Law.</p>	<p>člana u roku od dve (2) godine od dana stupanja na snagu ovog Zakona.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 23</b> <b>Odgovornost Rukovodioca subjekta javnog sektora za funkcioniranje unutrašnje revizije</b></p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora:</p> <p>1.1. osigurava dovoljno ljudskih, finansijskih i drugih resursa koji će omogućiti funkcionisanje unutrašnje revizije na efektivan način;</p> <p>1.2. usvaja strateške planove i godišnje revizije te ih dostavlja Centralnoj Jedinici za Harmonizaciju, najkasnije do 31. decembra fiskalne godine;</p> <p>1.3. osigurava sprovođenje dogovorenih preporuka za unutrašnjuunutrašnju reviziju;</p> <p>1.4. podnosi Ministarstvu finansija godišnji izveštaj o aktivnostima unutrašnje revizije iz člana 16. ovoga Zakona.</p>
--	--	--

<p align="center"><b>Neni 24</b> <b>Të drejtat e drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorëve të brendshëm</b></p>	<p align="center"><b>Article 24</b> <b>Rights of the Head of Internal Audit Unit and internal auditors</b></p>	<p align="center"><b>Član 24</b> <b>Prava direktora jedinice za unutrašnju reviziju i unutrašnje revizore</b></p>
<p>1. Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm kanë të drejtë:</p> <p>1.1. në qasje të lirë te menaxhmenti, anëtarët e personelit dhe pasuritë e subjektit të sektorit publik, që kanë të bëjnë me kryerjen e auditimit;</p> <p>1.2. në qasje të lirë në të gjitha informatat, përfshirë ato të klasifikuara sipas nivelit të tyre të qasjes së lejuar, qasje në sistemet e teknologjisë informative, të gjitha dokumentet dhe të dhënat në dispozicion, përfshirë edhe ato elektronike, që janë të domosdoshme për kryerjen e auditimit; dhe</p> <p>1.3. të kërkojnë nga zyrtarët përgjegjës çfarëdo të dhëna, pasqyra përmbledhëse, opinione, konfirmime, dokumente dhe informata tjera të nevojshme, në lidhje me detyrën e auditimit.</p> <p>2. Auditorët e brendshëm, pas miratimit nga drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe udhëheqësi i subjektit të sektorit publik, kanë të drejtë të verifikojnë strukturat dhe palët jashtë subjektit të</p>	<p>1. The Head of Internal Audit Unit and internal auditors shall have right to:</p> <p>1.1. Free access to the management, members of staff and assets of the Public Sector Entity related to the audit assignment;</p> <p>1.2. Free access to all information, including classified ones as per their respective level of clearance, access to Information Technology systems and all documents and records available, including the electronic ones, which are necessary for the performance of audit; and</p> <p>1.3. Request from the responsible officials data, summary statements, opinions, confirmations, documents and other information necessary in connection with the audit assignment.</p> <p>2. Internal auditors after approval of the Head of Internal Audit Unit and the Head of Public Sector Entity shall have the right to carry out checks in the structures and parties outside the Public Sector Entity, in</p>	<p>1. Direktor jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju i unutrarašnje revizore ima pravo na:</p> <p>1.1. slobodan pristup za upravljanje, članova osoblja i imovine subjekata u javnom sektoru, koji se bave sprovođenjem revizije;</p> <p>1.2. slobodan pristup svim informacijama, uključujući one klasificirane u skladu s njihovim nivoom dopuštenog pristupa, pristup sistemima informativne tehnologije, sva dokumenta i podatke na raspolaganju, uključujući i one elektroničke, koji su potrebni za obavljanje revizije; i</p> <p>1.3. Da zahtevaju od nadležnih bilo kakve podatke, sažete izjave, mišljenja, potvrde, dokumente i druge potrebne informacije u vezi sa zadatkom revizije.</p> <p>2. Unutarašnji revizori, nakon odobrenja od direktora jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju i rukovodioca subjekta u javnom sektoru, imaju pravo provere struktura i stranaka van subjekta javnog sektora, u</p>

<p>sektorit publik, në rastet kur kjo është e nevojshme për kryerjen e auditimit. Ky lloj verifikimi realizohet pas njoftimit paraprak sipas legjislacionit përkatës dhe në koordinim me menaxhmentin e strukturave dhe palëve ku realizohen verifikimet e tilla.</p>	<p>cases where this is necessary for the execution of audit assignments. This type of checks shall be carried out after a prior notification according to the relevant legislation and in coordination with the management of structures and parties where such checks shall be carried out.</p>	<p>slučajevima u kojima je potrebno provesti reviziju. Ova vrsta provere se sprovodi nakon prethodnog obaveštavanja rema važećim zakonskim propisima te u koordinaciji s menadžmentom struktura i stranaka gde se takve provere sprovode.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Obligimet e drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorëve të brendshëm</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Obligations of the Head of Internal Audit Unit and internal auditors</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Obveze direktora jedinice za unutrašnju reviziju i unutrašnjimunutrašnje revizore</b></p>
<p>1. Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm:</p>	<p>1. The Head of Internal Audit Unit and internal auditors shall:</p>	<p>1. Direktor jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju i unutrašnje revizore:</p>
<p>1.1. ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministri i Financave;</p>	<p>1.1. exercise their functions in an objective and professional manner and in accordance with the provisions of this Law and the internal audit methodology for the public sector approved by the Minister of Finance;</p>	<p>1.1. ostvaruju svoje funkcije na objektivan, profesionalan način i u skladu s odredbama ovoga Zakona i metodologijom unutrašnje revizije za javni sektor, koja je odobrena od strane Ministra finansija;</p>
<p>1.2. veprojnë në përputhje me kriteret e përcaktuara në kodin e etikës, planin e auditimit dhe rregullat për konfidencialitet për auditimin e brendshëm;</p>	<p>1.2. act in accordance with the criteria defined in the Code of Ethics, Audit Charter and the rules on confidentiality for internal audit;</p>	<p>1.2. deluju u skladu s kriterijumima utvrđenim u etičkom kodeksu, planom revizije i pravilima za poverljivost unutrašnje revizije;</p>
<p>1.3. zhvillojnë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale, dhe ruajnë certifikimin e tyre profesional duke marrë pjesë në 60 orë trajnim brenda dy (2) vite të njëpasnjëshme, në</p>	<p>1.3. continuously improve their knowledge, professional skills and maintain their professional certification in accordance with the criteria defined in Article 22 in this Law and attending</p>	<p>1.3. neprestano razvijaju znanje i profesionalne sposobnosti, te održavaju svoj profesionalni sertifikat sudjelujući u obukama za osposobljavanje od 60 sati u roku od dve (2) uzastopne godine,</p>

